



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E Kryeministrit - Ured Premijera - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Njësia Org. Org. Unit	02.2.d	Nr. Prot. Prot. No.	2640
Nr. i fàqeve Br. sfaqëve No. pages	PO	Data: Datam:	11 / 11 / 20 21
Prishtinë/a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**  
**Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**  
**Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave - Komisija za razmatranje žalbi -**  
**Complaints Review Commission**

11 nëntor 2021

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për procesin e rekrutimit në Bordet e Ndërmarrjeve Publike Qendrore i themeluar me Vendimin nr. 1131/2021, të datës 21 tetor 2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit në përbërje nga: Agron Gashi, kryesues, Fahrije Sadiku anëtare dhe Habit Hajredini, anëtare, duke u bazuar në nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-08 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-087, Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009 dhe në pajtim me nenin 130 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative mori këtë:

**V E N D I M**

1. **Ndalohet efekti pezullues i të gjitha ankesave për procesin e rekrutimit të Bordit Mbikëqyrës të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça" SH.A.**
2. **Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.**

**A r s y e t i m**

I. Duke par parasysht faktin se gjendemi në një situatë ku Bordit Mbikëqyrës të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça" SH.A. i ka kaluar mandati dhe tani udhëhiqet nga Bordi i Përkohshme i Drejtorëve.

Qeveria do ta ketë të pamundur zgjatjen e mandatit të tyre dhe rrjedhimisht Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça" SH.A do të mbetet pa Bord funksionale. Çdo përpjekje për zgjatjen ose përtëritjen e mandatit të këtij Bordi të Përkohshëm të Drejtorëve përtej afatit të përcaktuar

është e ndaluar, e pavlefshme dhe e pa zbatueshme, bazuar në nenin 43 paragrafët 43.4 dhe 43.5 ku përcaktohet:

*“43.4 Mandati i secilit Bord të Përkohshëm të Drejtorëve do të skadojë, cilado që ndodh më herët (i) mesnatën e ditës e cila rastis gjashtë (6) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji ose (ii) ditën në të cilën zgjidhet bordi i plotë i drejtorëve për NP-në përkatëse në përputhje me nenin 15 ose 16 të këtij ligji..*

*43.5 Çdo përpjekje për zgjatjen ose përtëritjen e mandatit të një Bordi të Përkohshëm të Drejtorëve përtej afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni është e ndaluar, e pavlefshme dhe e pa zbatueshme. Pas skadimit të mandatit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të Përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, ky bord dhe drejtorët e tij pushojnë të kenë çfarëdo autorizimi të çfarëdo përshkrimi për të vepruar në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së”.*

II. Duke u bazuar në “Parimin e të drejtës në mjete juridike” dhe “adresimin e Ankesës” të parapara në nenin 13 dhe 128 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit ka themeluar Komisioni për shqyrtimin e ankesave për procesin e rekrutimit në Borde të Ndërmarrjeve Publike në Republikën e Kosovës (Komisioni).

Gjatë procesit të përzgjedhjes së Bordeve të Ndërmarrjeve Publike, ka pasur disa ankesa kundër Listave të ngushta të publikuara në faqen e internetit të Zyrës së Kryeministrit.

Komisioni duke pas parasysh “Efektin pezullues të ankesës” të paraparë në nenin 130 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet:

*“Efektet e parashtrimit të ankesës*

- 1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankesë pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën.*
- 2. Nëse në aktin administrativ përfshihen dy ose më shumë palë me interesa të njëjta, ankesa e paraqitur nga njëra nga palët, pezullon prodhimin e pasojave juridike të aktit ndaj të gjitha palëve të përfshira.*
- 3. Organi publik, i cili shqyrton ankesën, mund të vendosë me akt administrativ, ndalimin e efektit pezullues të tij, nëse vonesa në ekzekutimin e tij mund t'i shkaktojë një dëm të*

*menjëhershëm dhe të pariparueshëm interesit publik apo një pale të tretë. Akti për heqjen e efektit pezullues, përveç elementeve të parapara nga neni 47 i këtij Ligji, do të përfshijë arsyetimin e ekzistencës së kushteve të parashikuara nga ky paragraf.*

*4. Pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit për ndalimin e efektit pezullues në gjykatën kompetente për konfliktet administrative, brenda pesë (5) ditëve nga njoftimi i tij.*

*5. gjykata merr vendim brenda pesë (5) ditëve dhe vendosë prishjen e vendimit për shkak të mosekzistencës së kushteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, apo për shkak të disproporcionalitetit të ndalimit të efektit pezullues”, sqaron:*

Sipas nenit 130 paragrafi 130.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, parashtrimi i ankesës pezullon prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj. Pezullimi i këtyre pasojave do të shpinte në zgjatjen e mandatit të bordeve të përkohshme dhe një gjë e tillë është e ndaluar specifikisht nga neni 43.5 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike i cili thotë që çdo përpjekje për zgjatjen ose përtëritjen e mandatit të një Bordi të Përkohshëm të Drejtorëve përtej afatit të paracaktuar është e ndaluar, e pavlefshme dhe e pa zbatueshme.

Për më tutje, neni 130 paragrafi 130.3 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative parasheh që efekti pezullues i ankesës mund të ndalohet nëse vonesa e ekzekutimit të aktit administrativ mund ti shkaktojë dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm interesit publik.

III. Duke marrë parasysh Bordit Mbikëqyrës të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore “Trepça” SH.A. i ka kaluar mandati dhe tani udhëhiqet nga Bordi i Përkohshme i Drejtorëve Ndërmarrje Publike, mandati i të cilëve u ka skaduar apo do të skadojë para përfundimit të procedurës administrative, pezullimi i ekzekutimit të aktit administrativ do të linte si pasojë këtë Ndërmarrje Publike pa bord respektiv të drejtorëve. Mbetja e kësaj Ndërmarrje Publike pa organin kryesor drejtues dhe menaxhues shkon në mënyrë jo proporcionale në dëm të interesit publik.

Sipas asaj që u tha në tekstin e lartë cekur dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit ,Komisioni vendos të **Ndalohet** efekti pezullues i të gjitha ankesave për procesin e rekrutimit të Bordin Mbikëqyrës të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore “Trepça” SH.A., sepse vonesa në ekzekutimin e tij mund t’i shkaktojë një dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm kësaj ndërmarrje dhe interesit publik.

## KËSHILLA JURIDIKE

Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vendimit për ndalimin e efektit pezullues në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Kryesuesi i Komisionit

Agron Gashi

---

Nënshkrimi:



Procesmbajtës

Nagip Tahiri

---

Nënshkrimi:

